



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË**

PROJEKT-VENDIM

Nr. Datë /05/2025

**MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË VEPRIMIT PËR
RININË 2025-2027**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr 68/2017, “Për financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjit nr.10296, date 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, I ndryshuar, Ligjit nr.152/2013 “Për nënpunësin civil” I ndryshuar, ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligjit nr.9367, date 07/04/2005 “Për parandalimin e konflikteve të interes në ushtrimin e funksionit shtetëror”, Ligjit nr.9154, date 06/11/2003 “Për Arkivat”, Ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin me publikun”. Kryetari i bashkisë Kolonjë në mbledhjen e datës .05.2025:

PROPOZOI:

- 1.Miratimin dhe Zbatimin e Planit Strategjik të Veprimit për Rininë të Bashkisë Kolonjë për vitin 2025-2027.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e bashkisë Kolonjë.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi në mbështetje të ligjit nr 139/2015.

KRYETARI
ERION ISAI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

Nr. 2356 Prot

Datë 21.05.2025

RELACION
PËR
PROJEKT – VENDIM
Nr. Datë /05/2025

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr 68/2017, “Për financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjit nr.10296, date 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, I ndryshuar, Ligjit nr.152/2013 “Për nënpunësin civil” I ndryshuar, ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligjit nr.9367, date 07/04/2005 “Për parandalimin e konflikteve të interesit në ushtrimin e funksionit shtetëror”, Ligjit nr.9154, date 06/11/2003 “Për Arkivat”, Ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin me publikun”.

1. Ky plan strategjik u realizua nga Anëtarët e Këshillit Vendor Rinor në bashkinë Kolonjë dhe organizata Përtej Barrierave në kuadër të projektit “Zë & Impakt-Fuqizimi i Këshillave Rinor për Ndryshimin e Komunitetit”. Projekti implementohet nga organizata Përtej Barrierave me mbështetjen e Fondacionit të Qendrës për Demokraci dhe financohet nga Bashkimi European.
2. Ky plan është hartuar me pjesëmarrjen aktive të të rinjve, anëtarë të Këshillit Vendor Rinor, të Bashkisë Kolonjë dhe ka për qëllim fuqizimin e tyre përmes politikave të orientuara drejt përfshirjes, zhvillimit social dhe ekonomik.
3. Misioni i kësaj strategjie është të krijojë një mjedis të favorshëm dhe gjithëpërfshirë për të rinjtë e bashkisë Kolonjë, duke u mundësuar atyre qasje më të lehtë në punësim, arsim dhe zhvillim profesional. Ajo synon të fuqizojë të rinjtë, duke i pajisur me aftësitë dhe burimet e nevojshme për të marrë pjesë aktive në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore të komunitetit dhe të ndërtojë baza të qëndrueshme për zhvillimin afatgjatë të zonës.

Konceptoi: Specialiste XH. KALEMAJ

Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P.P O.LIFO



PLANI I VEPRIMIT PËR BASHKINË KOLONJË (Draft)

Projekti “Zë & Impakt – Fuqizimi i Këshillave Rinor për Ndryshimin e Komunitetit”

PLANI STRATEGJIK I VEPRIMIT PËR RININË

Bashkia Kolonjë

Hartuar nga: Këshilli Vendor Rinor Kolonjë dhe Shoqata Përtej Barrierave

Mbështetur nga: Fondacioni Qendra për Demokraci

Financuar nga: Bashkimi Evropian

Ky plan është hartuar me pjesëmarrjen aktive të të rinjve, anëtarë të Këshillit Vendor Rinor, të Bashkisë Kolonjë dhe ka për qëllim fuqizimin e tyre përmes politikave të orientuara drejt përfshirjes, zhvillimit social dhe ekonomik.

PERMBAJTJA

Hyrje	4
Misioni, vizioni dhe qëllimi i strategjisë	4
Problematikat kryesore.....	4
Vlera apo vizioni	5
Misioni	6
Qëllimi	6
Objektivat SMART	8
Rezultatet.....	9
Burimet	10
Propozimi i vlerës	10
Partnerët kryesor	11
Aktivitetet kryesore	11
Burimet	12
Target audienca	13
Kanalet e angazhimit	14
Kostoja	14
Ku mund ti gjeni fondet?	15

Plani Lokal i Veprimit për Rininë

Ky plan strategjik u realizua nga Anëtarët e Këshillit Vendor Rinor në bashkinë Kolonjë dhe organizata Përtej Barrierave në kuadër të projektit “Zë & Impakt-Fuqizimi i Këshillave Rinor për Ndryshimin e Komunitetit”. Projekti implementohet nga organizata Përtej Barrierave me mbështetjen e Fondacionit të Qendrës për Demokraci dhe financohet nga Bashkimi European.

MISIONI, VIZIONI DHE QËLLIMI I STRATEGJISË

Problematika/t kryesore	Në kuadër të projektit "Zë dhe Impakt", i cili synon fuqizimin e këshillave rinorë për ndryshim në komunitet, Përtej Barrierave ka krijuar mundësi bashkëpunimi të ngushtë me Bashkinë Kolonjë për të mundësuar zhvillimin e këtij projekti, adresimin e sfidave më të mëdha me të cilat përballen të rinjtë në këtë zonë dhe ofrimin e mbështetjes dhe integritit të tyre. Nevojat e identifikuar janë të lidhura ngushtësisht me sfidat që të rinjtë përballen në fushat e punësimit, arsimit, përfshirjes sociale, dhe mundësive për zhvillim personal dhe profesional. Për të adresuar këto sfida, është realizuar një angazhim i vazhdueshëm që nga shtatori 2024 deri më tani, i cili përfshin të rinjtë, këshillin rinor dhe administratën e Bashkisë Kolonjë për të analizuar dhe kontribuar në hartimin e aktiviteteve dhe strategjive të nevojshme. Rezultatet e nxjerra nga diskutimet me të rinjtë, përfaqësues të bashkisë dhe këshillit rinor, si dhe aktivistë, kanë nxjerrë në pah nevojën për krijimin e qendrave, hapësirave dhe strukturave që mbështesin, përfshijnë dhe angazhojnë të rinjtë në këtë bashki. Këto nevoja janë analizuar dhe diskutuar nga ekspertë të fushës dhe janë identifikuar si aspekte kyçe për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe mundësive për të rinjtë në nivel lokal. Një nga sfidat kryesore për të rinjtë në këtë zonë është mungesa e mundësive për punësim. Papunësia mbetet një problem i madh, i ndërlidhur me mungesën e mbështetjes për iniciativat e sipërmarrjes rinore dhe zhvillimin e bizneseve të vogla. Prandaj, është thelbësore të krijohen mekanizma që i inkurajojnë dhe i ndihmojnë të rinjtë të nisin dhe të zhvillojnë aktivitetet e tyre ekonomike. Një tjetër problematikë e theksuar është aksesi i kufizuar në arsim dhe trajnim profesional. Mungesa e institucioneve të arsimit të lartë dhe qendrave të trajnimit profesional e bën të vështirë për të rinjtë që të ndjekin
--------------------------------	--

	rrugët e tyre të zhvillimit profesional. Në këtë kontekst, propozohet krijimi i një qendre këshillimi për karrierën, e cila do t'i ndihmonte të rinjtë të orientohen më mirë për të ardhmen e tyre akademike dhe profesionale. Përmirësimi i hapësirave dhe aktiviteteve rinore është një tjetër aspekt i rëndësishëm që kërkon vëmendje. Krijimi i një qendre për kurse në gjuhë të huaja për fëmijët dhe të rinjtë do të ishte një mundësi për të përmirësuar aftësitë e tyre gjuhësore dhe për të zgjeruar perspektivat e tyre. Po ashtu, shtimi i hapësirave kulturore, parqeve dhe mjediseve sportive do të ndihmonte në zhvillimin e një komuniteti më aktiv dhe të angazhuar. Organizimi i aktiviteteve artistike dhe kulturore, si konkurse muzikore, pikturë dhe aktrim, do të ofronte mundësi të reja për përfshirje sociale. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është përfshirja e personave me aftësi të kufizuara. Nevoja për një qendër multifunksionale për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara është e madhe, duke pasur parasysh mungesën e hapësirave të përshtatshme dhe shërbimeve specifike për ta. Një qendër e tillë do të siguronte mundësi më të mira për edukim, argëtim dhe përfshirje sociale për këta të rinj. Turizmi është një sektor me potencial të madh për zhvillimin e zonës dhe për krijimin e mundësive të reja për të rinjtë. Krijimi i pikave të informacionit për turistë, për promovimin e atraksioneve vendase do të ndihmonte në rritjen e interesit për këtë sektor. Gjithashtu, përfshirja e të rinjve në sektorin e turizmit përmes internship-eve dhe mundësive të punësimit do të ishte një hap i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të komunitetit. Mbështetja për studentët ekselentë është një tjetër hap kyç për të inkurajuar dhe motivuar të rinjtë që të ndjekin studimet e larta ose trajnimet e specializuara. Vendosja e një fondi për bursa për të rinjtë e talentuar do të ndihmonte në zhvillimin e kapaciteteve të tyre dhe në krijimin e një force punëtore të kualifikuar për të ardhmen. Së fundmi, nxitja e sipërmarrjes rinore përmes mbështetjes financiare dhe trajnimeve për të rinjtë që dëshirojnë të hapin biznese të reja në zonë do të ishte një strategji e rëndësishme për zhvillimin ekonomik lokal. Duke krijuar një ekosistem që mbështet idetë e reja të biznesit, do të mundësohej një zhvillim më i qëndrueshëm dhe një rritje e punësimit për të rinjtë e bashkisë Kolonjë.
Vlera apo vizioni	Strategjia e propozuar synon të adresojë nevojat dhe sfidat kryesore me të cilat përballen të rinjtë në bashkinë Kolonjë, duke krijuar mekanizma mbështetës dhe hapësira të dedikuara për zhvillimin e tyre. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është përmirësimi i cilësisë së jetës së të rinjve duke u ofruar atyre më shumë mundësi për arsim, punësim, sipërmarrje, kulturë dhe përfshirje sociale, duke krijuar kushte ku ata mund të zhvillojnë potencialin e

	tyre. Një nga shtyllat kryesore ku do të bazohet është nxitja e punësimit dhe fuqizimit ekonomik të të rinjve. Për të arritur këtë, do të krijohen mundësi të reja punësimi, duke u ofruar mbështetje për sipërmarrjen rinore dhe zhvillimin e aftësive profesionale. Strategjia gjithashtu do të fokusohet në rritjen e aksesit në arsim dhe trajnim profesional përmes qendrave të këshillimit për karrierën dhe programeve të specializuara të formimit. Për të nxitur përfshirjen dhe angazhimin e të rinjve, do të krijohen hapësira rinore, do të ofrohen kurse të gjuhëve të huaja dhe do të organizohen aktivitete artistike, sportive dhe kulturore. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është përfshirja e të rinjve me aftësi të kufizuara në jetën sociale dhe ekonomike. Strategjia synon të krijojë qendra të specializuara që ofrojnë mbështetje për zhvillimin e tyre. Për më tepër, duke pasur parasysh potencialin e zonës në turizëm, strategjia do të përfshijë angazhimin e të rinjve në këtë sektor përmes mundësive të internship-eve dhe punësimit. Mbështetja për studentët ekselentë dhe inkurajimi i sipërmarrjes rinore janë gjithashtu prioritetet kyçe të strategjisë, duke siguruar fonde për bursa dhe trajnime, si dhe mbështetje për krijimin e bizneseve të reja. Në terma afatgjatë, synimi është shndërrimi i bashkisë Kolonjë në një zonë ku të rinjtë kanë mundësi të barabarta për zhvillim dhe ku ata janë pjesë aktive e ndryshimit social dhe ekonomik.
Misioni	Misioni i kësaj strategjie është të krijojë një mjedis të favorshëm dhe gjithëpërfshirës për të rinjtë e bashkisë Kolonjë, duke u mundësuar atyre qasje më të lehtë në punësim, arsim dhe zhvillim profesional. Ajo synon të fuqizojë të rinjtë, duke i pajisur me aftësitë dhe burimet e nevojshme për të marrë pjesë aktive në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore të komunitetit dhe të ndërtojë baza të qëndrueshme për zhvillimin afatgjatë të zonës.
Qëllimi	Për të qenë në përputhje me vizionin dhe misionin e strategjisë, synohet të arrihen objektivat e mëposhtme, të cilat adresojnë nevojat konkrete të të rinjve në Kolonjë dhe zonat përreth: Një nga qëllimet kryesore është krijimi i hapësirave rinore dhe qendrave multifunksionale, si dhe nxitja e aktiviteteve kulturore dhe sportive. Në qytetin e Ersekës dhe në disa zona rurale do të krijohen dhe zhvillohen hapësira të dedikuara për të rinjtë, të pajisura me infrastrukturë moderne për të mbështetur zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Këto qendra do të shërbejnë si pika takimi ku të rinjtë do të kenë mundësi të mësojnë, të eksplorojnë interesat e tyre dhe të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore, artistike dhe sportive. Përmes organizimit të konkurseve artistike, festivaleve kulturore dhe garave sportive, do të promovohet talenti i tyre dhe do të forcohet ndjenja e përkatësisë dhe angazhimit komunitar.

	Një tjetër objektiv i rëndësishëm është rritja e mundësive për punësim dhe sipërmarrje rinore, duke shfrytëzuar potencialin turistik dhe ekonomik të zonës. Në bashkëpunim me institucione si biznese vendase, organizata dhe institucione arsimore, do të zhvillohen programe të specializuara për aftësi profesionale në sektorë me potencial zhvillimi si turizmi, agrobiznesi dhe zanatet tradicionale. Për shembull, do të ofrohen kurse mbi guidat turistike, prodhimin artizanale dhe teknikat moderne të bujqësisë organike. Të rinjtë që dëshirojnë të ndërmarin nisma të reja do të mbështeten përmes programeve të mentorimit, granteve fillestare dhe qasjes në rrjete biznesi, duke i ndihmuar ata të shfrytëzojnë burimet natyrore dhe kulturore të zonës për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Një aspekt tjetër thelbësor i strategjisë është përmirësimi i aksesit në arsim dhe formim profesional. Do të krijohen qendra këshillimi për karrierën dhe programe mbështetëse për të rinjtë që synojnë të ndjekin arsim të lartë ose të specializohen në fusha me kërkesë të lartë në tregun e punës, si teknologjia e informacionit, inxhinieria dhe shkencat mjekësore. Këto qendra do të ofrojnë informacione dhe orientim për mundësitë arsimore brenda dhe jashtë vendit, ndërsa studentët ekselentë dhe ata që dëshirojnë të ndjekin kurse të specializuara do të mbështeten përmes bursave dhe subvencioneve të financuara nga programet qeveritare dhe organizata donatore. Një tjetër objektiv i rëndësishëm është përfshirja dhe mbështetja e personave me aftësi të kufizuara. Për të garantuar barazinë e mundësive, do të përmirësohet infrastruktura e aksesueshme në qendrat rinore, shkolla dhe hapësira publike. Gjithashtu, do të zhvillohen programe të personalizuara për mbështetjen e këtyre të rinjve në tregun e punës, duke bashkëpunuar me qendrat e formimit profesional dhe bizneset sociale. Për shembull, do të ofrohen kurse në IT dhe punë artizanale për të rinjtë me aftësi të kufizuara, si dhe mbështetje për përshtatjen e vendeve të punës sipas nevojave të tyre. Këto hapa praktikë do të sigurojnë që strategjia të ketë një ndikim të qëndrueshëm dhe të ndihmojë të rinjtë të bëhen aktorë kyç dhe aktivë të ndryshimit në komunitetin e tyre. Duke u bazuar në nevojat dhe aspiratat e të rinjve, strategjia synon të krijojë kushte më të mira për zhvillimin e tyre personal, profesional dhe shoqëror, duke u dhënë mundësinë të angazhohen dhe të kontribuojnë në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për veten dhe për komunitetin e tyre.
--	---

OBJEKTIVAT SMART

Qëllimi 1: Krijimi i hapësirave rinore dhe qendrave multifunkionale, si dhe nxitja e aktiviteteve kulturore dhe sportive	Qëllimi 2: Rritja e mundësive për punësim dhe sipërmarrje rinore, duke shfrytëzuar edhe potencialin turistik të zonës	Qëllimi 3: Përmirësimi i aksesit në arsim dhe formim profesional	Qëllimi 4: Përfshirja dhe mbështetja e personave me aftësi të kufizuara
Objektivi 1.1: Deri në fund të vitit të parë, të identifikohen dhe rehabilitohen të paktën dy hapësira publike për t'u kthyer në qendra rinore multifunkionale. Objektivi 1.2: Brenda tre viteve, të organizohen të paktën 10 aktivitete kulturore dhe sportive, duke përfshirë konkurse artistike, festival dhe gara sportive me pjesëmarrje të gjerë të të rinjve. Objektivi 1.3: Deri në vitin e dytë, të krijohet një program i strukturuar i kurseve të gjuhëve të huaja dhe trajnimeve artistike në qendrat rinore për të paktën 100 të rinj.	Objektivi 2.1: Brenda tre viteve, të ofrohen trajnime profesionale për të paktën 150 të rinj në fusha me potencial punësimi, si turizmi, bujqësia dhe teknologjia. Objektivi 2.2: Brenda dy viteve të para, të krijohen të paktën tre pika informacioni turistik të menaxhuara nga të rinjtë për promovimin e atraksioneve vendase. Objektivi 2.3: Deri në fund të vitit të dytë, të mbështeten të paktën 10 nisma sipërmarrëse rinore për krijimin e bizneseve të vogla. Objektivi 2.4: Deri në vitin e tretë, të krijohet një program internship-i me bizneset lokale, duke siguruar praktika profesionale për të paktën 50 të rinj.	Objektivi 3.1: Deri në fund të vitit të parë, të krijohet një qendër këshillimi për karrierën, duke ofruar orientim profesional për të paktën 200 të rinj brenda tre viteve. Objektivi 3.2: Brenda tre viteve, të sigurohen të paktën 20 bursa për studentët ekselentë ose të rinjtë që dëshirojnë të ndjekin trajnime të specializuara. Objektivi 3.3: Deri në fund të vitit të dytë, të krijohen partneritete me të paktën tre institucione ose organizata për të sjellë trajnime dhe certifikime profesionale për të rinjtë.	Objektivi 4.1: Brenda tre viteve, të krijohet një qendër multifunkionale me hapësira të përshtatura për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara. Objektivi 4.2: Deri në vitin e dytë, të organizohen të paktën pesë aktivitete sociale dhe edukative që promovojnë përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara. Objektivi 4.3: Brenda tre viteve, të ofrohen programe trajnime dhe punësimi për të paktën 30 të rinj me aftësi të kufizuara, në bashkëpunim me bizneset dhe institucionet publike.

Rezultatet

Koha	Qëllimi 1: Krijimi i hapësirave rinore dhe qendrave multifunkzionale, si dhe nxitja e aktiviteteve kulturore dhe sportive	Qëllimi 2: Rritja e mundësive për punësim dhe sipërmarrje rinore, duke shfrytëzuar edhe potencialin turistik të zonës	Qëllimi 3: Përmirësimi i aksesit në arsim dhe formim profesional	Qëllimi 4: Përfshirja dhe mbështetja e personave me aftësi të kufizuara
Viti 1	- Identifikimi dhe rehabilitimi i të paktën 2 hapësirave publike për t'u shndërruar në qendra rinore. - Organizimi i 3 aktiviteteve kulturore dhe sportive për të rinjtë. - Nisja e një programi pilot për mësimin e gjuhëve të huaja për 50 të rinj.	- Organizimi i 2 trajnimeve profesionale për të paktën 50 të rinj në sektorë me potencial punësimi. - Hapja e 1 pike informacioni turistik të menaxhuar nga të rinjtë. - Mbështetja e 3 ideve sipërmarrëse me fonde fillestare.	- Krijimi i një qendre këshillimi për karrierën dhe ofrimi i shërbimeve për 50 të rinj. - Ofrimi i 5 bursave për studentët ekselentë ose për trajnime profesionale. - Nënshkrimi i marrëveshjeve me të paktën 1 institucion arsimor për ofrimin e kurseve profesionale.	- Identifikimi i nevojave të të rinjve me aftësi të kufizuara dhe zhvillimi i një plani për krijimin e një qendre multifunkzionale. - Organizimi i 2 aktiviteteve sociale për përfshirjen e tyre në jetën komunitare. - Përfshirja e 10 të rinjve me aftësi të kufizuara në trajnime për punësim.
Viti 2	- Rritja e funksionalitetit të qendrave rinore dhe zgjerimi i shërbimeve përfshirë kurse artistike dhe teknologjike. - Organizimi i 5 aktiviteteve të reja artistike dhe sportive. - Pjesëmarrja e të paktën 200 të rinjve në aktivitetet	- Ofrimi i 3 trajnimeve të reja profesionale për sektorë si turizmi, bujqësia dhe teknologjia. - Hapja e pikës së dytë të informacionit turistik. - Mbështetja e 4 ideve të reja sipërmarrëse rinore. - Krijimi i një programi internship-i me bizneset lokale	- Këshillimi i të paktën 100 të rinjve për karrierën dhe orientimin profesional. - Zgjerimi i bursave për të përfshirë edhe trajnime teknike të avancuara. - Bashkëpunimi me 2 institucione të reja për trajnime profesionale.	- Krijimi i një qendre multifunkzionale për të rinjtë me aftësi të kufizuara. - Organizimi i 3 aktiviteteve sensibilizuese për përfshirjen sociale. - Përfshirja e 15 të rinjve me aftësi të kufizuara në programet e trajnimit dhe punësimit.

	e qendrave rinore.	për 20 të rinj.		
Viti 3	- Funksionimi i plotë i qendrave rinore me një kalendar të rregullt aktiviteteve dhe kurseve. - Organizimi i një festivali të madh kulturor dhe sportiv. - Rritja e numrit të të rinjve të angazhuar në qendrat rinore në mbi 300 pjesëmarrës.	- Pjesëmarrja e 150 të rinjve në trajnimet profesionale. - Hapja e qendrës së tretë të informacionit turistik. - Mbështetja e 3 bizneseve turistike të reja të drejtuara nga të rinjtë me financim dhe mentorim. - Rritja e programit të internship-eve me 30 të rinj të angazhuar çdo vit.	- Arritja e 200 të rinjve të këshilluar për karrierën. - Ofrimi i 10 bursave të tjera për të rinjtë ekselentë. - Organizimi i një panairi arsimor për të promovuar mundësitë e edukimit dhe punësimit për të rinjtë e zonës.	- Integrimi i të paktën 20 të rinjve me aftësi të kufizuara në programe pune dhe trajnimi. - Ofrimi i shërbimeve të dedikuara në qendrën multifunksionale. - Rritja e ndërgjegjësimit për përfshirjen sociale përmes fushatave dhe aktiviteteve komunitare.

BURIMET

Propozimi i vlerës	Qasja jonë ndaj zhvillimit të të rinjve është gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme, duke u fokusuar në krijimin e një ekosistemi mbështetës që fuqizon të rinjtë jo vetëm përmes hapësirave dhe aktiviteteve, por edhe përmes mundësive konkrete për rritjen e tyre profesionale, kulturore dhe sociale. Synojmë të krijojmë një mjedis ku të rinjtë jo vetëm të marrin pjesë, por të ndihen të përfshirë në mënyrë aktive në proceset vendimmarrëse dhe zhvillimore të komunitetit të tyre. Strategjia jonë është e bazuar në nevojat reale të komunitetit dhe është hartuar për të nxitur angazhimin e të rinjve si faktorë të ndryshimit. Duke u bazuar në konsultime dhe analiza të vazhdueshme, ne zhvillojmë iniciativë që adresojnë sfidat me të cilat përballen të rinjtë dhe u japin atyre mjetet e duhura për të ndërtuar të ardhmen e tyre. Qasja jonë synon të integrojë të rinjtë në mënyrë aktive në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të zonës, duke u ofruar atyre mundësi të qëndrueshme për punësim, edukim dhe përfshirje sociale. Përmes trajnimeve, programeve të mentorimit dhe mbështetjes për sipërmarrjen rinore, synojmë të krijojmë kushte që i ndihmojnë të rinjtë të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të kenë një ndikim afatgjatë në komunitetin e tyre. Po ashtu, theksojmë rëndësinë e ndërtimit të hapësirave gjithëpërfshirëse, ku çdo i ri, pavarësisht prejardhjes apo sfidave me të cilat përballen, të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, kontribuar dhe ndërtuar një të ardhme më të mirë
Partnerët kryesor	Për implementimin e planit, bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm do të jetë thelbësor. Partnerët mund të

	përfshijnë: Organizatat rinore dhe shoqëria civile – për të zbatuar trajnime dhe aktivitete sociale që nxisin angazhimin e të rinjve dhe promovojnë zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Institucionet bashkiake dhe qeveritare – për mbështetje infrastrukturore dhe financiare, si dhe për krijimin e mundësive ligjore dhe administrative që mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve dhe programeve. Bizneset lokale dhe dhomat e tregtisë – për të krijuar mundësi punësimi dhe praktikash për të rinjtë, si dhe për të promovuar bashkëpunimin e të rinjve me tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik lokal. Institucionet arsimore dhe qendrat e trajnimit – për të ofruar kurse profesionale, trajnime dhe mentorim që i mundësojnë të rinjve të zhvillojnë aftësi praktike dhe profesionale. Organizatat ndërkombëtare dhe donatorët – për financim dhe asistencë teknike, duke siguruar mbështetje për zhvillimin dhe implementimin e aktiviteteve dhe projekteve, si dhe ndihmën për arritjen e objektivave afatgjata.
Aktivitetet kryesore	Për të siguruar suksesin e strategjisë, do të ndërmerren këto aktivitete: Zhvillimi dhe menaxhimi i qendrave rinore është një nga aspektet kyçe për krijimin e hapësirave funksionale ku të rinjtë mund të mblidhen dhe angazhohen. Këto qendra ofrojnë mundësi për zhvillimin e aftësive dhe ofrojnë një ambient të sigurt dhe mbështetës, ku rinia mund të shkëputet nga sfidat e përditshme dhe të angazhohet në aktivitete që nxisin krijimtarinë dhe zhvillimin personal. Për më tepër, organizimi i trajnimeve dhe programeve të mentorimit është i rëndësishëm për zhvillimin e aftësive teknike dhe profesionale të rinisë. Këto programe përfshijnë trajnime për sipërmarrje, teknologji dhe zhvillim profesional, duke u mundësuar të rinjve të rrisin aftësitë e tyre dhe të krijojnë mundësi për një karrierë të suksesshme. Aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive janë gjithashtu të rëndësishme për angazhimin e të rinjve në komunitet. Nxitja e aktiviteteve të tilla jo vetëm që promovon shëndetin dhe mirëqenien fizike, por

	gjithashtu i afron të rinjtë me njëri-tjetrin, duke krijuar mundësi për bashkëpunim dhe miqësi të reja. Bashkëpunimi me sektorin privat dhe publik është i domosdoshëm për të krijuar mundësi pune dhe praktika profesionale. Ky bashkëpunim mundëson që të rinjtë të zhvillojnë aftësi praktike dhe të përfitojnë nga mundësitë e ofruara nga bizneset dhe institucionet shtetërore, duke rritur mundësitë për punësim dhe avancim në karrierë. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është promovimi i turizmit rinor. Ky sektor ka potencial të madh për zhvillimin e ekonomisë lokale dhe për krijimin e mundësive të reja pune për të rinjtë. Inkurajimi i turizmit rinor mund të kontribuojë në rritjen e interesit për aktivitete dhe atraksione turistike, duke përfshirë të rinjtë në zhvillimin e këtij sektori. Përfundimisht, mbështetja për të rinjtë me aftësi të kufizuara është një element esencial për të garantuar akses dhe përfshirje të barabartë. Sigurimi i mundësive të barabarta për të rinjtë me aftësi të kufizuara është i nevojshëm për t'u siguruar që ata të kenë mundësi të zhvillojnë potencialin e tyre dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në shoqëri.
Burimet	Për realizimin e objektivave, do të nevojiten burime të ndryshme që do të mundësojnë një implementim të suksesshëm. Burimet sociale janë thelbësore dhe përfshijnë rrjete komunitare dhe partneritete me organizata lokale, të cilat do të mundësojnë angazhimin e të rinjve dhe bashkëpunimin e organizatave që punojnë për përmirësimin e kushteve të rinisë. Këto rrjete janë të rëndësishme për të krijuar mundësi dhe për të siguruar një mbështetje të qëndrueshme. Burimet njerëzore janë gjithashtu të domosdoshme, pasi ekspertët dhe trajnerët do të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e programeve edukative dhe mentorimit. Këta profesionistë do të ofrojnë njohuri dhe udhëzime për të rinjtë, duke i mbështetur ata për të zhvilluar aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të pasur sukses në karrierë dhe jetë sociale. Për më tepër, burimet publike janë të nevojshme, duke përfshirë hapësira të ofruara nga bashkia për qendra rinore dhe aktivitete. Këto hapësira do të shërbejnë si ambiente të sigurt dhe të pasura për zhvillimin e aktiviteteve, mundësitë për mësim dhe angazhim social. Bashkia duke ofruar këto hapësira, do të kontribuojnë në krijimin e një ekosistemi të favorshëm për rininë. Burimet fizike janë gjithashtu të rëndësishme për realizimin e objektivave, duke përfshirë infrastrukturën e

	përshtatshme për aktivitete dhe qendra edukative. Kjo përfshin ndërtesa dhe objekte të tjera që janë të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve dhe mbështetje për të rinjtë. Infrastruktura e mirë është një faktor kyç për të siguruar që aktivitetet të zhvillohen në kushte optimale. Në fund, burimet financiare janë të domosdoshme për mbështetje dhe realizim të projekteve. Kjo përfshin fonde nga donatorët, qeveria dhe sektorët privatë, të cilat mund të sigurojnë financimin e nevojshëm për zhvillimin e programeve, aktiviteteve dhe strukturave që mbështesin rininë. Këto fonde janë një nga elementët kryesorë që mundësojnë realizimin e qëllimeve dhe përfitimet për të rinjtë dhe komunitetin.
Target audienca	Audienca jonë kryesore përfshin një grup të gjerë dhe të ndryshëm individësh, të cilët kanë nevoja dhe mundësi të ndryshme. Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç sidomos të rinjtë me mundësi të pakta, janë një nga grupet kryesore që synojmë, duke u ofruar mundësi që të zhvillojnë aftësi dhe të integrohen më mirë në shoqëri. Ky grup shpesh përballet me sfida si papunësia dhe mungesa e mundësive, dhe për këtë arsye është i nevojshëm një mbështetje e veçantë për të siguruar mundësi për arsimim dhe angazhim. Një tjetër target i rëndësishëm është ai i studentëve dhe të sapodiplomuarve që janë në kërkim të mundësive profesionale. Ky grup ka nevojë për mundësi trajnimi dhe orientimi për të hyrë në tregun e punës, si dhe për mundësi për t'u angazhuar në aktivitete që do t'i ndihmojnë ata të ndërtojnë karrierën e tyre. Të rinjtë sipërmarrës janë gjithashtu një audiencë kyçe, pasi ata duan të zhvillojnë bizneset e tyre dhe kanë nevojë për mbështetje në formën e trajnimeve, mentorimit dhe mundësive për financim. Ky grup ka potencialin për të krijuar mundësi punësimi dhe zhvillim ekonomik, por ka nevojë për resurse dhe ndihmë për të zhvilluar idetë e tyre në nivele më të larta. Gjithashtu, një grup tjetër i rëndësishëm përfshin personat me aftësi të kufizuara, të cilët kërkojnë përfshirje më të madhe sociale dhe ekonomike. Këta individë shpesh hasin pengesa në aksesin e mundësive edukative dhe punësimi, dhe për këtë arsye, është e nevojshme të sigurohet një mbështetje e veçantë për ta, duke ofruar mundësi dhe hapësira për t'u integruar plotësisht në shoqëri.
Kanalet e angazhimit	Për të komunikuar dhe përfshirë audiencën, do të përdoren një gamë e gjerë mjetesh dhe kanalesh për të siguruar që mesazhet të arrijnë tek ata që kanë nevojë për mbështetje dhe mundësi. Mediat sociale, përfshirë Facebook, Instagram, LinkedIn dhe TikTok, do të jenë kanale kryesore për promovimin e aktiviteteve dhe mundësive për të rinjtë. Përdorimi i këtyre platformave do të mundësojë arritjen një

	audiencë të gjerë dhe të inkurajojmë pjesëmarrjen e tyre në programe dhe aktivitete. Për të ofruar informacion të detajuar dhe të organizuar, mund të përdoret gjithashtu një uebfaqe dhe buletine elektronike. Këto mjete do të ndihmojnë në shpërndarjen e përditësime mbi programet dhe mundësitë që ofrohen, si dhe të sigurojë informacion të nevojshëm për aplikim dhe pjesëmarrje. Pjesëmarrja aktive në nivel lokal është thelbësore për përfshirjen e të rinjve në aktivitete prandaj do të organizohen takime me komunitetin dhe forume rinore për të siguruar që të rinjtë të jenë të informuar dhe të angazhuar. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi të hapur dhe inkurajues për pjesëmarrje. Në të njëjtën kohë, do të zhvillohen bashkëpunime me shkolla, universitete dhe biznese për të promovuar mundësitë e formimit profesional. Kjo do të mundësojë të ofrimin e mundësive praktike dhe mbështetje për ata që janë në kërkim të mundësive për të zhvilluar aftësitë dhe karrierën e tyre.
Kostoja	Për të operuar dhe realizuar qëllimet e projektit, do të nevojiten fonde të mjaftueshme për mbështetje të veprimtarive të ndryshme që janë të domosdoshme për zhvillimin e strategjisë. Infrastruktura (pajisje, hapësira, mirëmbajtje e qendrave rinore): Ky segment përfshin kostot për krijimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave rinore funksionale. Kjo mund të përfshijë renovimin e hapësirave ekzistuese, pajisjet për aktivitetet (kompjuterë, tabela, materiale për aktivitete praktike, etj.), si dhe shpenzime për mirëmbajtjen e vazhdueshme të këtyre hapësirave. Pritet që ky segment të kërkojë një investim fillestar dhe më pas një mbështetje të vazhdueshme për mbajtjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë. Pagat e stafit dhe ekspertëve: Financimi i pagave për profesionistët dhe ekspertët e angazhuar në zbatimin e aktiviteteve të kësaj strategjie është një investim i vazhdueshëm që do të mbulojë trajnerët, ekspertët në fusha të ndryshme (si zhvillimi i aftësive profesionale, sipërmarrja, mentorimi, etj.), si dhe menaxhimin e aktiviteteve. Ky fond synon të sigurojë që profesionistët të jenë të motivuar dhe të pajisur me kompetencat e nevojshme për të ofruar aktivitete me cilësi të lartë për të rinjtë. Për shembull, mund të përfshihen kosto për pagat mujore të një koordinatori të trajnimeve, një eksperti të mentorimit, si dhe trajnerëve që do të mbajnë kurse për aftësi teknike. Organizimi i aktiviteteve dhe trajnimeve për të rinjtë: Ky fond do të mbulojë koston e materialeve dhe pajisjeve për aktivitete, shpenzimet për zhvillimin e kurseve të trajnimit, pagat për instruktorët dhe shpërblimet për pjesëmarrësit. Aktivitetet mund të përfshijnë kurse për zhvillimin e aftësive profesionale

	(p.sh., kurse për teknologji, artizanat, apo aftësi për menaxhim biznesi) dhe aktivitete kulturore e sportive. Kjo mund të përfshijë gjithashtu transportin dhe logjistikën për pjesëmarrësit. Fushatat e promovimit dhe komunikimit: Për të siguruar që strategjia dhe aktivitetet e ofruara të arrijnë audiencën e duhur, do të nevojiten fonde për fushata publicitare dhe promovuese. Ky fond mund të mbulojë kosto për krijimin e materialeve promociionale, si broshura, postera, video promociionale dhe publikime në mediat sociale. Gjithashtu, mund të përfshijë fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete publike që lidhen me temat e projektit, si mundësitë për të rinjtë, aftësitë që ata mund të zhvillojnë, dhe mundësitë për integrimin e të rinjve në shoqëri.
Ku mund ti gjeni fondet?	Për të siguruar burime financiare dhe për të mbështetur zhvillimin e projektit, mund të shfrytëzohen disa mundësi financiare të ndryshme, të cilat mund të ofrojnë mbështetje për realizimin e qëllimeve të parashikuara. Një nga mundësitë kryesore janë fondet e BE-së dhe grante nga organizata ndërkombëtare që mbështesin projekte rinore dhe sociale. Këto mund të përfshijnë financime për aktivitete që synojnë përmirësimin e mundësive për rininë, zhvillimin e aftësive profesionale dhe aktivitete që kanë ndikim pozitiv në shoqëri. Komisioni Evropian dhe organizatat ndërkombëtare, si UNICEF dhe UNDP, shpesh ofrojnë mundësi për financime të drejtpërdrejta për projekte që kanë si qëllim zhvillimin social, integrimin e të rinjve dhe përfshirjen sociale. Një tjetër mundësi është grantet nga qeveria dhe institucionet lokale. Qeveria shqiptare, si dhe autoritetet lokale, shpesh ofrojnë fonde për projekte që synojnë zhvillimin e komunitetit dhe mbështetjen e rinisë. Këto mund të përfshijnë fonde të dedikuara për zhvillimin e qendrave rinore, aktivitete kulturore dhe sportive, si dhe mbështetje për programe që i ofrohen rinisë për të rritur aftësitë e tyre profesionale dhe shoqërore. Gjithashtu, mund të eksplorohet mundësia e bashkëpunimeve me sektorin privat, ku mund të sigurohen sponsorizime dhe partneritete. Bizneset lokale dhe kombëtare shpesh janë të gatshme të investojnë në projekte që kanë ndikim pozitiv në komunitet, si dhe përfitojnë nga mundësitë e promovimit të markës së tyre përmes aktiviteteve rinore dhe sociale. Partneritetet me sektorin privat mund të ofrojnë fonde për organizimin e aktiviteteve, si dhe mund të krijojnë mundësi për të rinjtë për t'u angazhuar në mundësi praktike dhe punësimi.

	Për më tepër, mund të gjenerohen të ardhura nga shërbime dhe aktivitete, si kurse, evente dhe projekte sipërmarrëse. Këto mund të përfshijnë mbledhjen e tarifave për pjesëmarrësit në kurse ose aktivitete trajnimi, si dhe mundësinë e zhvillimit të projekteve sipërmarrëse që krijojnë mundësi për të rinjtë dhe kontribuojnë në vetëfinancimin e projektit. Kombinimi i këtyre burimeve financiare mund të sigurojë një mbështetje të qëndrueshme dhe të bollshme për realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe për mbështetje të qëndrueshme afatgjatë.
--	---